



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-325/05 1445/24

Nr. i fq. / Br.str. / No.pg.

Data / Datum / Date 15.01.2024

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.22.12.2023, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë:

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Propozim Vendimit nr.-I-162, të dt.15.12.2023 për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal Obiliq për vitin 2024
4. Shqyrtimi i kërkesës së DAP-së, nr.-III-347, të dt.14.12.2023 për dhënien në diskutim publik të Projekt Rregullores për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve
5. Shqyrtimi i kërkesës së DPUKP-së, nr.- V-1576, të dt.15.12.2023 Propozim Vendimi nr.-V- 1577, i dt.15.12.2023 për miratim paraprak të Listës së përgjithshme dhe Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2024
6. Shqyrtimi i kërkesës nr.-II-1814 të dt.15.12.2023 për Planin e Veprimt për barazi gjinore për vitin 2024-2026
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Propozim Vendimit nr.-I-162, të dt.15.12.2023 për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal Obiliq për vitin 2024.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ti rekomandohet Kuvendit Komunal ky plan dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Ne ishim pjesëmarrës në këtë takim për punën që ju veç e kishit përfundue për çka ju falenderojmë. Është një plan që duhet të jetë për vitin paraprak, kështu që ne edhe në këtë mbledhje të KPF-së edhe në seancën e radhës e votojmë pro sepse është një dokument mbi bazën e të cilit ne duhet me bartë punën tonë. Unë vetëm kisha me propozue që përveç këtij propozim dokumenti është që ta kemi edhe një raport financiar të Kuvendit Komunal, sepse një diçka të tillë nuk kemi pasë më herët. Do të thotë në një pikë tjetër të rendit të ditës, apo sido që të jetë raportet e Ekzekutivit i kemi vazhdimisht por edhe raportin financiar të Kuvendit Komunal është mirë ta kemi në fundvit dhe besoj se nuk na bën dëm diçka neve si Kuvend.

Kryesuesja – Jo aspak nuk i bën dëm askujt, nuk duhet të jetë këtu por do të bisedoj me drejtoreshën e financave që me i dhënë të dhënat te raporti i KK por raporti financiar është i përfshir në raportin e Ekzekutivit. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për i rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Propozim Vendimit nr.-I-162, të dt.15.12.2023 për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal Obiliq për vitin 2024.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DAP-së, nr.-III-347, të dt.14.12.2023 për dhënien në diskutim publik të Projekt Rregullore për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo Projekt Rregullore ti rekomandohet Kuvendit dhe të dalë në debat publik.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës ti rekomandohet Kuvendit, që i njëjti të merrë vendim për dhënien në debat publik.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DAP-së, nr.-III-347, të dt.14.12.2023 për dhënien në diskutim publik të Projekt Rregullore për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DPUKP-së, nr.- V-1576, të dt.15.12.2023 Propozim Vendimi nr.-V- 1577, i dt.15.12.2023 për miratim paraprak të Listës së përgjithshme dhe Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2024.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo pikë të kalon sepse për çdo vit kjo pikë e rendit të ditës kalon në Kuvend, pastaj në bazë të listës edhe mund ta japim kontributin tonë në Kuvend. Ne një herë kemi dhënë prona dhe aty është një procedurë që shpallet, konkurrohet, prezantohet delë në Kuvend dhe votohet për ose kundër kështu që ne jemi për që kjo pikë të kalojë.

Sami Ahmeti – Gjithçka çka shkon në Kuvend me bisedue është e mirëseardhur, por ne në këtë pikë abstenojmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës së DPUKP-së, nr.- V-1576, të dt.15.12.2023 Propozim Vendimi nr.-V- 1577, i dt.15.12.2023 për miratim paraprak të Listës së përgjithshme dhe Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2024.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nr.-II-1814 të dt.15.12.2023 për Planin e Veprimit për barazi gjinore për vitin 2024-2026.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës të shkojë në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që të shkon në Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për i rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimi i kërkesës nr.-II-1814 të dt.15.12.2023 për Planin e Veprimit për barazi gjinore për vitin 2024-2026.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Kryetari i Komunës për shqyrtimin e Marrëveshjes Kornizë e Bashkëpunimi Ndërkomunal Shumëfunksional nr.- II-1840-e dt.20.12.2023.

Enver Gashi – Ne një herë veç jemi dakordue dhe jemi për marrëveshjet ndërkomunale.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që ti rekomandohet Kuvendit Komunal dhe është mirë që Ekzekutivi të jetë i përgatitur dhe të na jepë shpjegime, përveç asaj që shkruan sepse kjo është marrëveshje e përgjithshme që i përfshin 6 Komuna dhe gjatë seancës me na informue se cilat janë të mirat që i sjellen qytetarit të Obiliqit me këtë marrëveshje. Gjithsesi, çdo bashkëpunim kur është brenda kornizave të Komunave, kur ia don të mirën Republikës së Kosovës, jo që jemi dakord por edhe e apllauzojmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Marrëveshjes Kornizë e Bashkëpunimi Ndërkomunal Shumëfunktional nr.- II-1840 e dt.20.12.2023.

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga Kryesia e SHSAK Obiliq, për mbështetje financiare për të gjithë të punësuarit në administratën e Komunës së Obiliqit, për vitin 2023. Në seancën e Kuvendit drejtoresha e DEFZH-së, do të japë sqarime lidhur me këtë kërkesë edhe zyrtarja ligjore ta njoftoj Kuvendin se a bëjmë shkelje ligjore nëse, marrim një vendim të tillë.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ti rekomandohet Kuvendit kjo kërkesë dhe drejtoresha e financave si dhe zyrtarja ligjore ta sqarojnë çështjen pastaj, ne të marrim vendim.

Sami Ahmeti – Tash, ne me këtë kërkesë veç po fillojmë me përdorë parime të dyfishta domethënë edhe kërkesat tjera se sindikata shumë në rregull dhe jam i informuar se kanë nevoja. Unë jam i informuar edhe prej Ministrisë se shumë prej zyrtarëve kanë problemin e koeficientit dhe janë shumë keq. Pajtohem plotësisht me atë fushën se vërtetë, me këto të hyra që i kanë është vështirë me i mbulue shpenzimet e familjes. Ne zakonisht së pari kërkojmë prej Drejtorive sepse edhe për kërkesat tjera, mundemi me rekomandue me thënë që të jetë drejtori i kësaj fushe dhe mbaron. Pra, ne po i thejmë parimet tona që i kemi vendosë që çdo kërkesë fillimisht të shkon te Drejtoria, e cila vjen me rekomandime pastaj ta dërgojmë. Duke qenë se jemi në muajin e fundit, ne e japim pëlqimin që të shkoj në Kuvend pa garantue se jemi pro në seancë.

Kryesuesja – Z.Ahmeti, ka ardhë si rekomandim nga Kryetari që kjo kërkesë të shkon në Kuvend dhe aty të jetë e pranishme drejtoresha e financave, e cila do ta sqaroj. Për këtë arsye unë kërkoja që edhe zyrtarja ligjore të prezentoj sepse nëse merret vendim duam të dimë se a bëjmë shkelje ligjore nëse, nga Kuvendi Komunal ndahen mjetet për shërbyesit civil apo jo.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës nga Kryesia e SHSAK Obiliq, për mbështetje financiare për të gjithë të punësuarit në administratën e Komunës së Obiliqit, për vitin 2023 dhe po ashtu, drejtoresha e DEFZH-së si dhe zyrtarja ligjore të japin sqarime lidhur me kërkesën në fjalë.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Fuad Hashani, Kryetar i Këshillit të lagjes Obiliq i vjetër. Si shqetësim i banorëve të lagjes është objekti i dedikuar kohë më parë për çerdhe që nuk është vënë në funksion asnjëherë. Pasi që objekti në fjalë ka filluar të demolohet dhe shfrytëzohet nga narkomanët e njerëzit e panjohur që paraqet rrezik për banorët, kërkohet nga organet kompetenete të renovohet apo të rrenohet në tërësi dhe në ato hapësira të ndërtohet kënd për lojëra.

Enver Gashi – Unë sa kam informata ajo ndërtesë është punuar nga një OJQ me destinim çerdhe të fëmijëve. Komuna nuk ka marrë pjesë në financa, pranimi teknik nuk është bërë kurrë dhe tash ne duhet me bërë një zgjidhje, e jo me lënë ashtu sepse në mëshirën e kohës ai objekt sigurisht se shfrytëzohet për të keq, e jo për të mirë. Kjo kërkesë duhet ti drejtohet Drejtorisë përkatëse.

Kryesuesja – Mendoj se duhet drejtuar në Drejtori të inspeksionit sepse këtu po përmendet një punë shumë e ndijshme, të njoftohet policia, duhet DSHPE-ja, DPUKP-, do të thotë se këtu janë disa sektorë që përfshihen.

Sami Ahmeti – Për mos me kalue si kërkesë në pikën të ndryshme, unë kisha me kërkue prej këtyre institucioneve, janë një javë ditë kohë deri në seancën e Kuvendit edhe nëse fare nuk i përgjegjemi z.Fuad, është me rëndësi me ditë çka po vendosim dhe çka po bëjmë me atë objekt sepse kur po ndodhin gjëra negative në shoqëri jemi përgjegjës secili që dimë dhe mundemi me ndërpre diçka. Jemi dëshmitarë se çdo ditë po ndodhin gjëra të dëmshme për shoqërinë tonë dhe çka nëse, ai objekt shërbehet për diçka që ia vret

jetën dikujt. Edhe pse e ka ndërtuar një OJQ, ne jemi institucion, jemi organi më i lartë ligjvënës në Komunë ndërsa, Ekzekutivit ia japim të gjitha mundësitë që atë objekt ose me kthye në diçka tjetër, ose me formalizue. Pranim dorëzimi që nuk është bërë pse nuk është bërë dhe cilat janë hapat që merren, kështu që është mirë deri në seancën e Kuvendit dikush me na dhënë një përgjegje të tillë pa dashtë me dalë prej rendit të ditës, pasi po bëjmë fjalë për këtë pikë. Gjithsesi, pajtohem që gjithmonë kur një kërkesë vjen me ardhë përfaqësuesit e asaj Drejtorie dhe me na dhënë shpjegime edhe ligjore, por edhe të mundësive financiare se a është e mundshme apo jo me u aplikue ajo punë. Unë për mos me përsëritë shumë në të ndryshme kërkoj që në seancën e ardhshme krejtë personat e involvuar që ndërlidhen me këtë kërkesë, ose ta bëjnë një raport të përbashkët ose një person që na raporton, jo në atë formën me na raportue, por me na tregue se çka mundemi edhe ne me bë secili prej pozicionit tonë.

Kryesuesja – Ne do të ia rekomandojmë Drejtorive përkatëse dhe zyres ligjore, do të kërkojmë nga ata që në mbledhjen e Kuvendit të jenë prezentë, që të na njoftojnë se çka është puna e këtij objekti.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për i rekomanduan DPUKP-së, kërkesën nr.-I-34890/23, e dt.06.12.2023, nga Fuad Hashani.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj kam pranuar një email nga z.Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit për Draft Strategjinë e zhvillimit socio –ekonomik lokal 2023-2027. Pas ardhjes së kërkesave shtesë dhe komenteve nga Kryetarët e Këshillave Lokal deri me datën 22 do të na sjellin këtë Draft dokument. Në momentin që do ta kemi këtë Draft dokument ne do të ua përcjellim juve.

Ajshe Haliti Pllana – Unë i kam 3 kërkesa:

1.Në kohën e fundit jemi informuar se një vajzë e vogël e familjes Mjekiqi, është diagnostifikuar me leukemi dhe unë po bëjë kërkesë publike dhe në ndërkohë nuk e di nëse, familja ka bërë apo jo kërkesë për ndihmë financiare për atë vajzë të vogël.

2.Kërkesa shkon lidhur me Drejtorinë e Arsimit për shkollën "Dr.brahim Rugova" rregullimi i ndriçimit në oborrin e shkollës pasi që prindërit nuk i shohin fëmijët e tyre kur po dalin prej shkollës në orën 17:00 që është edhe natë, kështu që fëmijët edhe po frigohen dhe prindërit aty, po krijohet një tollovi. Prandaj, ndriçimi është shumë i rëndësishëm.

3. Mosmbyllja e parkingut të shkollës sepse parkingu i shkollës nuk i takon askujt do të thotë iu takon nxënësve, të gjithëve. Mbyllja e parkingut po shkakton kaos sepse kombit mbeten jashtë që i marrin fëmijët dhe prindërit, që shkojnë me vetura do të thotë bëhet një lëmsh i madh aty. Mendoj se nuk ka nevojë askush me mbyllë parkingun, pasi që ai është mjaft i madh dhe munden me shfrytëzue për të mirë atë parking të shkollës dhe mos me pasë asnjë tollovi aty.

Sami Ahmeti – Në fillim të seancës është mirë me caktue ne se çka mundemi me i ndihmue për rastin, por kjo është kërkesë që veç e bëri znj.Ajshe. Sa i përket kërkesës paraprake lidhur me shqyrtimin e Draft Strategjisë, ne në seanca në fillim të leximit të rendit të ditës e kemi mundësinë me shtue ose me heqë një pikë të rendit të ditës dhe nuk prish punë, kështu që jemi dakord që kjo të shkoj. Në ndërkohë e kam një kërkesë që në seancën e ardhshme dikush kush është përgjegjës të na përgjegjet që si rezultat i dhënies së pronave publike përgjatë gjithë pasluftës në Komunën e Obiliqit, sa është numri i të punësuarve të Komunës tonë si rezultat i dhënies së këtyre pronave.

Enver Gashi – Sa i përket Draft Strategjisë ne jemi që kjo të kaloj, por të kompletohet me dokumentacion të nevojshëm dhe të jetë si pikë e veçantë e rendit të ditës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal, që të përfshihet si pikë e 8 e rendit të ditës shqyrtimi dhe aprovimi i Draft "Strategjisë socio-ekonomike të Komunës së Obiliqit 2023-2027".

Bajram Hashani - Unë e kam një kërkesë në lagjen e Hashanëve edhe pse nëse nuk gaboj e ka dërguar edhe Fuadi, por nuk di pse nuk ka ardhë sikurse kjo për

Çerdhe. Është një shtyllë e ndriçimit, që është e drurit, por vërtetë ajo shtyllë nuk e di qysh nuk është rrëzuar dhe ia kanë bërë disa përforcime. Nëse, ka mundësi DSHPE-ja, edhe pse janë të njoftuar janë duke e

neglizhuar këtë problem prandaj mundësisht të intervenohet sa nuk është bërë ndonjëfarë dëmi më i madh sepse mund të bjen dhe seriozisht nuk di si po qëndron.

Kryesuesja – Ne pyetjet e juaja do ti përcjellim te Drejtoritë përkatëse dhe do të kërkojmë nga ata që në mbledhjen e Kuvendit të vijnë me sqarime.

Mbledhja përfundoi në ora 11:36'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

